



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 490B/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Zenel Krasniqi pjesëtar i FSK-së dhe Vjollca Shala në cilësinë kryesueses së Vendvotimit (VV) 0314e në fshatin Negrovc komuna e Drenasit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik (LVV), me të cilën pretendohet se janë vërejtur disa persona duke votuar më shumë se një herë. Këtë parregullsi sipas parashtrësimit të ankesës e kanë paraqitur te Vjollca Shala si kryesueses e Vendvotimit 0314e në Negrovc komuna e Drenasit, e cila nuk ka ndërmarr asgjë lidhur me parregullsinë e paraqitur. Ndërsa pjesëtari i FSK-së Zymer Krasniqi i ka kërcënuar vëzhguesit duke thënë se “kur të bie terri do ti qërojmë hesapet”.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 4 paragrafi 2 parasheh:

PZAP-i mund ti hidh poshtë (si të palejuara, të parregullta parregullta apo të pasafatshme) ankesat të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP-refuzon ankesat të cilat janë të pabazuar, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e Panelit të Zgjeruar të datës 16.12.2010, Anr. 490/2010. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24)*

orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 490B/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

